

**SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE**

Nr. _____ Prot

Lushnje, më ____ . ____ 2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Materiale Elektrike për nevojat e Shoqërisë”
“Marrvëshje Kuadër me një Operator Ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuar, me afat 12 muaj”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pajisje Materiale Elektrike 31681410-0

VLERA E FONDIT LIMIT: 2.774.401,78 (dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e katërqind e një presje shtatëdhjetë tetë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Autoriteti Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje Sh.A ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojces 9 ;*

b. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;*

Fondi limit është përllogaritur nga grupi i punës me Urdhër Nr.23 datë 03/02/2026 sipas studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të ofertave nga tre operatorë të ndryshëm, të marra nga ky studim.

Argumentim : Komisioni ka bërë përllogaritjen e fondit limit për “**Blerje Materiale Elektrike**”, në prokurimin që do të zhvillojë Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lushnje sh.a, në rolin e Autoritetit Kontraktor. Në zbatim të pikës 1, Neni 35, Kreu VI të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në Nenin 34 “Përllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe në Nenin 76 (Menyrat për

perlllogaritjen e vleres se prokurimit) pika c, të VKM nr.285, date 19.05.2021 per Miratimin e rregullave te prokurimit publik në vijim të Regjistrimit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2026.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

2.1.2. Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarise se Operatorit Ekonomik i njejte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.1 Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklarave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare **(2023-2024-2025), ku vlera mesatare e së cilës, të jetë jo më e vogël se 40% e vleres se llogaritur te kontrates.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3, neni 43 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvorë të nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitin financiar 2023-2024-2025, të paraqitura dhe miratuara nga organet perkatese tatimore si dhe të shoqeruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e percaktimeve të Ligjit nr.25/2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025, si dhe kestet e matura për vitin 2026 pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës. **Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Operatori Ekonomik fitues duhet të dorëzojë prane AK, përpara lidhjes së Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar. **PASI** Mbështetur në faktin që në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST, ofertuesit vetëdeklarojnë, ndër të tjera që “Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së”, **ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të Kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar (lidhur me procedurën e hapur të thjeshtuar).

Specifikimeve Teknike

3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë :

3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë CE (kur është e aplikueshme) dhe/ose raporte testimi, për të gjithë mallrat objekt prokurimi ose ekuivalente .

Argumentim: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e Specifikimeve Teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

3.2

Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë që merr për sipër transportin dhe levrimin e mallrave ambjentet magazinues të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim

Autoriteti Kontraktor në formulimin e kriterit për kapacitetin transportues të mallrave i qëndron rigorozisht faktit se Operatori Ekonomik i cili do të shpallet fitues duhet të kryejë edhe transportin në destinacion të mallrave objekt prokurimi për nevojat e Autoritetit Kontraktor i cili nuk do të paguaj shpenzime shtesë për këtë shërbim.

Argumentimi i Specifikimeve Teknike

*Specifikimet Teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përlogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës Nr.8. për ato pika të cilat përfshihen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori Ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara lidhjes së Kontrates, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.